

Drita Bejtullahi¹
Bukurije Etemi-Ademi²

UDC: 347.61/.64

**TRENDËT AKTUALË NË TË DREJTËN FAMILJARE DHE
IMPLIKIMET LIGJORE NGA PRAKTIKAT E SË DREJTËS FAMILJARE**

**ТЕКОВНИ ТРЕНДОВИ ВО СЕМЕЈНОТО ПРАВО И ПРАВНИ
ИМПЛИКАЦИИ ОД ПРАКТИКИТЕ НА СЕМЕЈНОТО ПРАВО**

**CURRENT TRENDS IN FAMILY LAW AND LEGAL IMPLICATIONS
OF FAMILY LAW PRACTICES**

Abstract

Evolution and changes in society also play their role in the legal system and laws of the society. Current trends related to the family in general and the Family law, in particular, don't just influence the lives of people, their familial relationships and perception, but they could also interfere with the decision-making on the advancement and adoption of Family Law Legislation. Even though, the majority of people are still aligned with the traditional way of the family, the latest trends play quite a role in defining the overall concept of the family and Family law. Today, the family institution itself is faced with first of all, the broadened definitions of the family concept and family law practices, likewise. So, transformations in Family law practices have a great impact on family related issues such as marriage, divorce, civil union, parenting, support and maintenance, child custody, etc. and could cause a great deal of institutional implications when it comes to settling or combating claims and lawsuits arising from them and consequently seeking and finding the most suitable legal protection available. Today's solutions and legal protection could consist not only by traditional court sessions and hearings, but they could find themselves being aided by the latest technologies, or outside court mediations and settlements. Staying informed about trends and novelty on this

¹ Assistant Professor at the Faculty of Law, University of Tetova, NMK
E-mail: drita.bejtullahi@unite.edu.mk

² Assistant Professor at the Faculty of Law, University of Tetova, NMK
E-mail: bukurije.etemi@unite.edu.mk

matter is not just a concern for the people involved, but it is also a complicated and delicate subject matter for law institutions, students, scholars and legal representatives.

Keywords: *Family law, trends, traditional family, marriage, legal protection.*

Hyrje

Ky punim ka për qëllim të trajtojë zhvillimet dhe ndryshimet familjare të cilat kanë ndodhur dhe po ndodhin përgjatë historisë së njerëzimit dhe të cilat nuk kanë ndikuar vetëm jetën njerëzore dhe raportet familjare, por gjithashtu kanë ndikuar, në masë jo të vogël edhe në formimin dhe përshtatjen e legjislacionit mbi familjen. Trendët modernë mbi kuptimin dhe institucionin e familjes ballafaqohen tashmë, me një definicion më të zgjeruar të konceptit mbi familjen, por edhe mbi praktikën dhe ligjin mbi familjen. Megjithatë, shumica e njerëzve nuk pajtohen dhe janë ithtarë të linjës tradicionale të familjes, tendencat dhe lëvizjet moderne kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në definimin dhe transformimet që i ndodhin familjes dhe ligjit mbi të. Këto ndryshime kanë ndikuar në shumë çështje të lidhura me familjen, sikurse janë martesat, divorci, prindërimi, bashkësia familjare, bashkëjetesa civile, kujdesi për fëmijën, alimentacioni, dhe në të njëjtën kohë, kanë shkaktuar edhe implikime të tjera institucionale dhe ligjore, kur bëhet fjalë për çështjen e përfaqësimit dhe mbrojtjes ligjore në raste të parashtrimit të padive dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Sot, zgjidhja e këtyre kontesteve, përveç me mënyrën gjyqësore tradicionale, ka mundësi të asistohet edhe nga përdorimi i teknologjisë, ose ndërmjetësimeve dhe ujdive jashtëgjyqësore. Çështje tjetër me rëndësi, jo vetëm për palët e përfshira, e cila po ashtu është delikate dhe e ndërlikuar, qoftë për institucionet në fjalë, për studiuesit, shkencëtarët dhe përfaqësuesit ligjorë, është edhe informimi i duhur mbi këta trendë dhe novitete.

Struktura e familjes dhe karakteristikat e saj

Raportet dhe struktura familjare kanë pësuar ndryshime mjaft evidente gjatë periudhës së kaluar, me paraprirje të popujve dhe familjeve perëndimore, duke u ndjekur, në masë jo të vogël edhe nga pjesa tjetër e popujve dhe shoqërive botërore. Këto ndryshime të strukturës së familjes, sot po zëvendësojnë dhe anashkalojnë gjithnjë e më shumë familjen tradicionale. Janë bërë trend dhe gjithnjë e më të zakonshme të ashtuquajturat familje me strukturë alternative, në veçanti familjet njëprindëshe, ato të përziera (familja e njerëzve) dhe

familjet me prindër të gjinisë së njëjtë.³ Ndoshta nuk është shumë e largët koha kur dominonte familja nukleare, me dy prindër (të martuar) dhe fëmijët biologjikë në një bashkësi familjare, të cilën akoma e synojnë numër i madh çiftesh dhe të rinjsh, por për shkak të rrethanave dhe ndryshimeve të mëdha shoqërore është bërë e vështirë që ajo të mbijetojë si e tillë, pa pasoja dhe rënie serioze. Dhe, të mos flasim për familjen e zgjeruar tradicionale, e cila kryesisht përbëhej nga më tepër se katër anëtarë (përveç prindërve dhe fëmijëve, anëtarë kishte edhe gjyshërit, stërgjyshërit, tezë, hallat, dajallarët, xhaxhallarët, kushërinjtë, etj.). Si familje e zgjeruar mund të definohet trungu i një familjeje nukleare, nga i cili zgjerohet grupimi me prejardhje njëlineare, qoftë ky zgjerim i ardhur përmes linjës së gruas, ose linjës së burrit (Britannica, 2025). Me këtë lloj definicioni mund të nënkuptohen edhe familje të përbëra nga anëtarë të një farefisi të ndryshëm me ata të familjes nukleare. Familje të gjera ekzistojnë akoma në pjesë të ndryshme të botës, por edhe aty ndryshimi ndodh me të rinjtë brenda tyre, të cilët krijojnë familjet e veta dhe vendosin që të mos jetojnë në atë bashkësi më tutje (Ruggles & Heggeness, 2008). Në situata të këtilla më të moshuarit jo vetëm që e humbin ndikimin mbi brezat më të rinj të familjes, por ngrihet shqetësimi që ata në pleqëri të mos kenë mbështetjen e duhur nga familjarët e tyre (Grundy, 2006; Taylor et al., 2018). Familja e zgjeruar ka qenë tipike për periudhat përpara familjeve të përmendura më lartë.

Përveç në vet strukturën e familjes, ndryshimet ndodhin edhe në rrethanat dhe rolet tjera brenda familjes, sikurse janë detyrimet dhe obligimet familjare, duke u nisur nga kujdesi dhe furnizimi i familjes, prindërimi, kryerja e punëve të shtëpisë; kjo edhe si rezultat i numrit në rritje të grave dhe bashkëshorteve të cilat janë bërë pjesë e barabartë e fuqisë punëtore. Të gjitha këto ndryshime të strukturës së familjes janë manifestuar me rënie të martesave (veçanërisht atyre tradicionale), pra të rinj që po martohen gjithnjë e më vonë dhe familjet po bëhen gjithnjë e më të vogla në numër, me lindshmëri të vogla dhe më pak fëmijë nëpër familje,⁴ përderisa, nga ana tjetër, divorci ka shënuar rritje të madhe, rimartesa ka çuar në më shumë martesa dhe familje të përziera. Shumë njerëz vendosin që të bëhen prindër duke shfrytëzuar një nënë surrogate për të arritur deri te lindja e fëmijës që dëshirojnë. Po ashtu, rritje kanë shënuar familjet të cilat si kryefamiljar kanë një grua.

³ Kur flasim për këto çrregullime në familjet moderne, tregues i mirë do të ishte vetëm një studim i bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku mbi “16 milionë prindër amerikanë pa bashkëshort në familje jetojnë me fëmijën e tyre nën moshën 18 vjeçare, nga 4 milionë sa ishte në vitin 1968 dhe rreth 14 milionë në vitin 1997.” Po ashtu, rënia e martesave dhe rritja e numrit të fëmijëve të lindur nga çiftë të pamartuara, rezultojnë me rritjen e numrit të kujdesit prindëror jashtëmartesor. Pra, me rritjen e numrit të prindërve të pamartuar, rritet numri i fëmijëve që jetojnë me një prind të pamartuar. Në vitin 1968, 13% e fëmijëve - gjithsej 9 milionë - jetonin në këtë lloj strukture dhe më 2017 kjo përqindje kishte arritur rreth 1/3 (32%) e fëmijëve amerikanë, apo 24 milionë. (Studim i Pew Research Center: pewresearch.org).

⁴ <https://www.americansurveycenter.org/research/emerging-trends-and-enduring-patterns-in-american-family-life>

Por, në fakt, cilat janë shkaqet dhe arsytet më të zakonshme të cilat kanë nxitur dhe kultivuar ndryshimet e përmendura?

Në qoftë se marrim për model karakteristikat e familjes nukleare, autori dhe sociologu William J. Goode ka trajtuar këtë çështje që prej gjashtëdhjetë vjetësh, duke parashikuar ndikimet që sistemi i familjes perëndimore mund të kishte nëpër pjesë të tjera të botës. Dhe, pikërisht këto ndryshime po i shohim sot se si janë përhapur bashkë me të ashtuquajturin globalizëm, thuajse në të gjithë botën. Goode, në librin e tij “World Revolution and Family Patterns” (1963) thekson mundësinë që sistemet familjare nëpër botë të njëjtësohen me modelin perëndimor të familjes së vogël të bashkëshortëve dhe fëmijëve dhe jo të atyre të zgjeruara të përbëra nga më tepër breznit dhe kjo, në përshtatje me përhapjen e tregut kapitalist dhe ekonomisë së bazuar në vendet e punës, ekonomisë industrialiste dhe postindustrialiste, në vend të familjes dhe ekonomisë familjare të deriatëherëshme bazuar kryesisht në sigurimin e të ardhurave familjare nga puna bujqësore. Parashikimet e tij përkojnë, përveç me reduktimin në numër të bashkësive familjare, edhe me lidhjet më të fuqishme martesore, pjellshmërinë më të ulët, rënien e numrit të familjeve shumëbrezash, në përshtatje me familjen perëndimore që tashmë kërkonte më shumë arsimim dhe shpërndarje gjeografike. Madje, ky sistem, sipas tij, do të çonte në liri më të madhe të zgjedhjes së partnerit, bazuar në dakordim dhe ndjenjë, e jo në interesin e pjesës tjetër të familjes, duke zvogëluar në këtë mënyrë kontrollin familjar dhe humbjen e autoritetit të moshuarve të familjes. Pra, në shumë shoqëri ndryshimet në modelin e familjes kanë ardhur si rezultat i përshtatjeve shoqërore, në mënyrë transitore nga ekonomia tradicionale e të mbijetuarit, në një ekonomi të orientuar në prodhim dhe e aftë për eksport në agrobiznes, prodhimtari dhe industri, transformim i cili zgjeron ekonominë e bazuar në vende pune e cila favorizon më të rinjtë, dukë përfshirë po ashtu, edhe të rejtat dhe vajzat.⁵

Në të njëjtën linjë, Therborn (2004) thekson ndikimin e së drejtës dhe politikës publike, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim. Përmendet edhe ndikimi i ndryshimeve demografike në rënien e mortalitetit dhe pjellshmërisë si rezultat i organizimit të moshës së martesës dhe shtatzënisë (Bongaarts J, Mensch BS, & Blanc AK, 2017).

Ndikimi i teknologjisë reproduktive në organizimin e kursit jetësor

Teknologjia reproduktive apo shtatzënia e asistuar, e njohur gjerësisht si fertilizim in vitro, nga aspekti mjekësor vjen si një zgjidhje për shumë njerëz dhe çifte (qoftë gra ose burra), të cilët kanë vështirësi dhe nuk mund të kenë fëmijë në mënyrë natyrale edhe pas procedurave, terapive dhe mjekimeve të ofruara, në veçanti nga mjekësia e organizuar formale. Qendra Amerikane për

⁵ Frank F Furstenberg: Family Change in Global Perspective: How and Why Family Systems Change <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC8298013/#ABS1>

Kontrollin e Sëmundjeve e definon teknologjinë e asistuar reproduktive si çfarëdo qasje trajtimi të fertilitetit në të cilin vezoret apo embrionet manipulohen.⁶ Pra, me këto metoda anashkalohet kontakti fizik mashkull-femër dhe si zëvendësim shfrytëzohet fertilizimi i vezoreve i kryer në mënyrë artificiale në laborator. Sot fertilizimi i asistuar ekziston në më tepër forma apo teknika të njohura si: OI - Induksioni i ovulacionit, IVF - Fertilizimi in vitro, PIGD - Diagnoza gjenetike paraimplantuese, MRT - Terapia e zëvendësimit mitokondrial, GIFT - Transferimi intrafallopian i gametave, RS - Kirurgjia reproduktive, C - Krioprezervimi, ICSI - Injektimi intracitoplazmik i spermës, etj. (Wikipedia). Fëmija i parë i lindur me anë të një metode të asistuar, me fertilizim in vitro vjen në vitin 1978, për t'u zhvilluar dhe përhapur më pastaj si metodë në mënyrë shumë të shpejtë në tërë botën, si një zgjidhje e shumëpritur për shumë njerëz, por nga ana tjetër, jo pa pasoja dhe raste të shoqëruara me probleme dhe çrregullime të mëvonshme. Një metodë e këtillë zakonisht aplikohet pas shterimit të mjekimeve dhe mundësive të tjera ekzistuese.

Edhe përkundër trajtimit dhe zgjidhjes së problemit të infertilitetit të miliona çifteve, reproduktimi i asistuar megjithatë, ka shkaktuar, ose më mirë thënë do të shkaktojë një sërë shqetësimesh dhe tronditjesh, para së gjithash nga aspekti moral dhe etik, ai social dhe ligjor. Në qoftë se, me të vërtetë kjo lloj teknologjie do të ndikonte në ndryshimin e pikëpamjes dhe vlerësimin mbi jetën e njeriut dhe pretendimin mbi pasardhësin tonë gjenetik, mbi drejtësinë dhe barazinë sociale,⁷ atëherë kjo gjë mund të çonte në devijime të mëdha të asaj që ne jemi mësuar të shohim dhe vlerësojmë lidhur me krijimin e familjes, strukturën e saj, por mbi të gjitha, mbi krijimin e jetës dhe mënyrën e organizimit të saj në një të ardhme, ndoshta jo shumë të largët. Nga aspekti juridik, përveç ndryshimeve ligjore që duhet bërë për të përfshirë këta trendë unikë të jetës njerëzore, do duhet pasur kujdes që ato të zbatohen në mënyrë të përgjegjshme shoqërore.⁸

Trendët më të zakonshëm në strukturën e familjes

Familja, raportet familjare dhe gjeneratat sot janë më të ndërlikuara dhe 'shumëngjyreshe', krahasuar me familjet e disa brezave më parë, sikurse janë gjithnjë e më të pranueshme modelet e reja në rritje të tyre. Ndryshimet më të mëdha kanë ardhur në periudhën e tridhjetëvjeçarit të fundit, me forma të reja të 'bashkësive familjare,' si p.sh. modeli familjar i bashkëjetesës dhe unionit,⁹ kurse kanë pësuar rënie modelet e lidhjeve familjare afatgjata, siç është modeli

⁶ Meaghan Jain; Manvinder Singh. Assisted Reproductive Technology (ART) Techniques. (<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK576409/>)

⁷ The Ethical, Legal, and Social Issues Impacted by Modern Assisted Reproductive Technologies <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC3261493/>

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

i familjes universale, ai i martesës së hershme, asaj formale dhe të aranzhuar. Me këtë është nxitur edhe njohja ligjore e mënyrës alternative të krijimit të familjes, krahas mundësisë së shpërbërjes së familjes me anë të divorcit.¹⁰ Duhet thënë që format e përmendura janë karakteristike për shtete dhe rajone të caktuara, sikurse është p.sh poligjinia, si një formë unioni familjar.¹¹ Megjithatë, duke pasur parasysh ‘shumëllojshmërinë’ familjare sot, është vështirë të thuhet se cili tip apo model familjar është më dominuesi, më në numër, krahasuar me modelet tjera që njohim. Pavarësisht nëse ndryshimet e përmendura kanë ndodhur ose jo tashmë, apo kanë ndodhur vetëm pjesërisht, mund të konstatohet që ndryshimi ndoshta nuk ka prekur të gjitha aspektet e familjes dhe strukturës së saj, megjithëse ai ka një shtrirje konstante dhe gjithëpërfshirëse në shoqërinë njerëzore.

Po të analizohet vetëm martesë dhe institucioni i martesës si një segment parësor i çështjes në fjalë, mund të konstatohet që ato po pësojnë ndryshime thelbësore gjithandej, si rezultat i ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike. Niveli i moshës për martesën e parë ka shënuar rritje për shumicën e popujve të botës dhe ai nuk ka prekur vetëm Evropën perëndimore, por edhe popujt e Evropës lindore, pjesë të mëdha të Azisë lindore, madje Afrikës dhe Amerikës Latine.¹² Rrjedhimisht, vet rritja e moshës së martesës është indikator i rënies së pjellshmërisë. Po ashtu, sipas disa studimeve, personat me moshë më të madhe mund të marrin vendimet pa u ndikuar nga familja e tyre, për zgjedhjen e partnerit, shtyrjen e martesës, madje të mos martohen fare, ose të vendosin për një lidhje heterogamie, etj.; dukshëm ka ndikuar edhe punësimi në numër i femrave.¹³

Për një numër të madh të rinjsh martesë po bëhet një nga opsionet alternative të krijimit të familjes. Një nga zgjidhjet alternative me shtrirje të gjerë, e cila praktikohet shumë, është kohabitacioni. Kjo gjendje i referohet një çifti të pamartuar në një lidhje, i cili jeton së bashku. Si një lidhje familjare, kohabitacioni mund të nënkuptojë edhe një bashkësi me më shumë anëtarë, të cilët nuk janë në lidhje familjare dhe në bazë të ligjit (UK) nuk ka një definicion për të (Stowe Family Law). Më i theksuar është në mesin e njerëzve me gjendje më të mirë ekonomike.¹⁴

Jo vetëm që kemi rënie të numrit të martesave të lidhura për së pari herë, apo vonesë të saj dhe zëvendësim të martesës tradicionale me format e përmendura, por nga ana tjetër kemi prishjen e martesave apo divorcin, i cili

¹⁰ Po aty.

¹¹ Family change and variation through the lens of *family configurations* in low- and middle-income countries

Andrés Felipe Castro Torres, Luca Maria Pesando, Hans-Peter Kohler, Frank Furstenberg
<https://doi.org/10.1002/psp.2531>

¹² Frank F Furstenberg: Family Change in Global Perspective: How and Why Family Systems Change

<https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC8298013/#ABS1>

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

zakonisht ndodh si rezultat i pakënaqësisë së një çifti në lidhjen martesore. Megjithëse ka numër të madh njerëzish dhe çiftesh, të cilët në njëfarë mënyre e kanë prishur lidhjen e tyre martesore, përkohësisht ose përgjithmonë, divorci megjithatë nënkupton shpërbërjen e martesës nëpërmjet një procedure gjyqësore. Sipas World Population Review, ekzistojnë matje të ndryshme të cilat tregojnë normat e divorcit dhe ato kryesisht i referohen numrit të divorceve të ndodhura në një shtet të caktuar, llogaritur si përqindje nga numri i përgjithshëm i popullatës së regjistruar për vitin në fjalë dhe jo numrit të martesave. Numri total pastaj, ndahet në mënyrë të barabartë për çdo 1000 persona dhe del shifra e çdo njëmijëshe, por shpeshherë llogaritet përqindja e divorceve edhe nga numri i përgjithshëm i martesave. Pavarësisht shkaqeve të shumta të divorcit, ai nuk karakterizon një popull a kulturë të caktuar, por është i përhapur në tërë botën.¹⁵ Pasqyra mund të mos jetë krejtësisht reale dhe e njëjtë për të gjitha shtetet, varësisht nga mënyra dhe mundësitë ligjore, madje edhe nga perceptimi dhe liria individuale për të ndërmarrë dhe realizuar një akt të tillë.

Rënia e pjellshmërisë e cila nuk lidhet vetëm me dukurinë e martesave të vonuara dhe trendët e shumtë përreth tyre dhe që padyshim çon në natalitet më të ulët, ka të bëjë shumë edhe me gjendjen e përgjithshme shëndetësore, e veçanërisht atë riprodktive të individit, qoftë një femre apo një mashkulli. Nga aspekti mjekësor, infertiliteti është identifikuar dhe trajtuar që prej mijëra vitesh, megjithatë duke pasur parasysh rritjen e kësaj dukurie bashkë me kohët më të reja janë bërë edhe studime të shumta të cilat kanë çuar deri te metodat më të avancuara moderne të pllenimit artificial, siç janë in vitro dhe të tjera dhe tani kjo dukuri mund të definohet si një nga sëmundjet bashkëkohore të organeve të sistemit riprodhues të njeriut (WHO, GLOWM). Pavarësisht nga problemi i pjellshmërisë, moslindja është një problem në vete, e cila ndodh për arsye të ndryshme, më tepër individuale dhe është më e theksuar te popujt më të pasur (Kreyenfeld & Konietzka, 2017; Rowland, 2007), siç janë popujt evropianë, popujt anglishtfolës dhe popujt me zhvillim ekonomik të Azisë, siç janë Japonia, Koreja dhe Tajvani.

Ndryshim në vete është fuqizimi i gruas dhe rritja e ndikimit të saj në zhvillimet e përgjithshme sociale, ekonomike dhe politike, duke kontribuar në ndërrimin e roleve të burrave dhe grave si në pjesëmarrje në vendet e punës, ashtu edhe në kryerjen e punëve dhe obligimeve familjare. Avancimi i të drejtave të grave me lëvizjet për barabarësi gjinore ka rezultuar me qasje më të madhe të tyre në sistemin arsimor dhe tregun e punës, megjithëse praktikatat e dhunës bashkëshortore dhe seksuale janë raportuar të jenë probleme mjaft serioze edhe në vende të cilat i kanë legalizuar të drejtat në fjalë (Yount, 2009).

¹⁵ Radhitja e shteteve sipas shkallës së divorcit, për 1000 persona brenda një viti (2023): Maqedonia e Veriut - 9.6, Lihtenshtajni - 4.9, Bjellorusia - 3.7, Gjeorgjia - 3.7, Letonia - 2.8, Andorra - 2.7, Kostarika - 2.6, etj. Kurse me numrin më të ulët renditen Sllovenia - 1.0, Kroacia - 1.1, Ishujt Faroe - 1.2, Mali i Zi - 1.3, Uzbekistani - 1.4, Holanda - 1.4, Bullgaria - 1.4, Mongolia - 1.4, etj. (World Population Review, 2025).

Zbehja e kuptimit të martesës formale bashkë me prirjet tjera të lidhjeve jashtëmartesore shoqërohet nga praktika gjithnjë e më e madhe e marrëdhënieve jashtëmartesore jo vetëm seksuale, por edhe ajo e lindjes së fëmijëve nga këto marrëdhënie.¹⁶ Kjo dukuri, në qoftë se praktikohet nga persona të cilët tashmë janë të martuar apo në lidhje tjetër familjare, ndikon jo vetëm tek individët në fjalë, por edhe te shoqëria si tërësi, duke shkaktuar një varg problemesh dhe pasojash tek familja, raportet bashkëshortore, e në veçanti te fëmijët të cilët mund të jenë pjesë e këtij rrethi familjar. Këto veprime, të cilat zakonisht kryhen pa njohurinë dhe lejen e partnerit, njihen si afëra romantike të formës së tradhtisë dhe mashtrimit dhe të cilat në raste të shumta bëhen shkaktarë të prishjes së raporteve bashkëshortore dhe familjare.

Struktura e familjes në Maqedoninë e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut struktura e familjes është kryesisht me përbërje të zgjeruar shumëgjeneratëshe dhe me më shumë anëtarë në një bashkësi familjare, apo të paktën kjo ka qenë karakteristike shikuar nga perspektiva tradicionale e organizimit të familjes. Kjo karakteristikë është më e theksuar te bashkësitë tjera etnike, siç janë shqiptarët dhe disa bashkësi të tjera dhe më pak te maqedonasit, gjë në të cilën ka ndikuar edhe gjendja ekonomike dhe pamundësia e të rinjve për të pasur vende pune personale, që do të thotë se kjo mënyrë tradicionale e ka bërë më të lehtë qoftë përballimin e ngarkesës financiare, qoftë edhe ndarjen e punëve të tjera brenda bashkësisë familjare. Gjatë dekadave të fundit kemi gjithnjë e më shumë të rinj të cilët kanë krijuar familjet e tyre të vogla nukleare, megjithëse tendenca është që shumë prej tyre t'i kenë shtëpitë pranë familjarëve tjerë, veçanërisht ata nëpër vendbanimet rurale. Organizimi hierarkik i familjes ka qenë kryesisht patriarkal, nën udhëheqjen dhe vendimmarrjen e burrit më të moshuar të familjes, meqenëse ky aspekt ka ndryshuar shumë dhe tani vendimmarrja në shumë familje nuk bëhet në mënyrë të tillë. Mosha e anëtarëve të familjes dhe përbërja e trungut familjar vazhdon që të respektohet, edhe përkundër faktit që anëtarët e familjes së gjerë mund të mos jetojnë të gjithë në një shtëpi, përsëri ata kanë marrëdhënie shumë të afërta dhe ndihmojnë në punët familjare të njëri-tjetrit dhe familjes së zgjeruar, në veçanti në kujdesin për më pleqtë dhe fëmijët e vegjël. Ndryshimi më i madh i karakterit të familjes në Maqedoninë e Veriut ka ardhur si

¹⁶ Sipas statistikës së Eurostat-it lidhur me normën e martesave dhe divorceve në UE për vitin 2023 ka rënie të të dyjave, por si rezultat i numrit gjithnjë e më të vogël të martesave, që krahasuar me vitin 1964, rënia është me 50% për martesat. Përqindja më e ulët e divorceve nuk nënkupton ulje të numrit të tyre, por vjen si rezultat i numrit në rënie të martesave dhe po ashtu, edhe për shkak të legalizimit të divorcit në disa shtete të UE-së. Për sa i takon numrit të lindjeve, kjo statistikë tregon jo vetëm rënie të përgjithshme, por që numri i lindjeve jashtëmartesore i tejkalon lindjet nga martesat e rregullta, madje në 6 shtete të UE-së për vitin në fjalë (Bullgari, Portugali, Francë, Suedi, Slloveni dhe Estoni).

rezultat i migrimit të shumë anëtarëve të familjes, madje edhe familjeve të tëra jashtë shtetit, të shtyrë nga kushtet e vështira ekonomike dhe politike, megjithatë shumica e tyre vazhdojnë që të mbajnë lidhje të ngushta dhe të rregullta me vendlindjen dhe pjesën e mbetur këtu të familjes.¹⁷

Sa i përket ndryshimit strukturor dhe trendëve ‘modernë’ të familjes në Maqedoninë e Veriut, rol të madh kanë luajtur, përveç tjerash, edhe pjesa e familjarëve të cilët jetojnë jashtë vendit, në diasporë. Ata, përveç mjeteve financiare dhe të mirave të tjera materiale që kanë sjellë në vend, kanë ndikuar jo pak edhe në çështjen e krijimit të familjes dhe vetë trendit të martesës. Mundësia për krijimin e kushteve më të mira materiale nga ana e familjarëve dhe të rinjve ka ndikuar pikë së pari që, çiftet e reja të ndahen në familje dhe shtëpi personale. Por nga ana tjetër, si ikja e të rinjve, ashtu edhe vonesa e martesës, ka ndikuar në rënien e natalitetit, kjo e lidhur edhe me vështirësitë në pjellshmëri dhe përfundimin jo të suksesshëm të shtatzënisë.¹⁸ Janë shumë rrethana, pa e përfshirë ndikimin e diasporës, që kanë depërtuar nëpërmjet të teknologjisë moderne, mundësive për përfitim të njohurive dhe mësim nga shembuj të caktuar të familjes (jo gjithmonë të qëlluara), qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me anë të mediave, të cilat dita-ditës po lënë gjurmë te të rinjtë, rrjedhimisht edhe te pikëpamja e tyre reale mbi familjen dhe mënyrën e organizimit të jetës personale. Pra, janë trendë globalë, të përmendur më lartë, që po manifestohen në të gjitha sferat e krijimit dhe organizimit të një familjeje dhe që po e ndryshojnë krejtësisht karakterin e familjes sonë tradicionale, e cila akoma mundohet të qëndrojë si e tillë.

Roli i femrave në familje dhe veçanërisht pjesëmarrja në ekonominë familjare është rritur me kyçjen gjithnjë e më të madhe të tyre në tregun e punës, kjo edhe si rezultat i rritjes së nivelit të arsimimit të tyre dhe migrimit të brendshëm nëpër zona urbane. Por, nga ana tjetër, edhe ky është një indikator i cili i kontribuon devijimit nga bërthama tradicionale e familjes, duke e ndikuar këndvështrimin mbi planifikimin e familjes dhe të ardhmen e saj.

Ligji për Familjen i Maqedonisë së Veriut rregullon “martesën dhe familjen, marrëdhëniet në martesë dhe familje, forma të caktuara të mbrojtjes

¹⁷ Në mënyrë më të theksuar gjatë dy dekadave të fundit, familje të tëra kanë migruar në vendet e Evropës perëndimore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australi dhe Zelandën e Re. Ky fenomen dikur ishte shumë më i theksuar te shqiptarët etnikë të vendit, por me kalimin e kohës numri është rritur shumë edhe te maqedonasit dhe bashkësitë tjera etnike.

¹⁸ Sipas Entit Shtetëror të Statistikës së Maqedonisë së Veriut (2022), vetëm për një dhjetëvjetor kemi rënie të natalitetit nga 11.2% në 10.2%, ndërsa kemi rritje edhe të mortalitetit nga 9.5% në 15.5%. Numri i martesave ka rënë për 9.5%, ndërsa numri i divorceve është rritur për 12.0%; mosha mesatare nga martesa e parë për meshkuj është rritur në 29.8 v. nga 28.3 v., kurse ajo e femrave, nga 25.4 v. në 27.0 v. Numri më i madh i divorceve ka ndodhur në grupmoshën nga 30 deri 34 vjeçe. Bazuar në kohëzgjatjen e martesës, numri më i madh i divorceve është bërë në periudhën nga 5 deri 9 vjet pas kurorëzimit të martesës. Kësaj statistike po t’i shtohet edhe rënia e numrit të përgjithshëm të popullsisë (rreth 237 000 apo 11.4% banorë më pak), këto ndryshime të përqindjes do të ishin edhe më të mëdha.

së posaçme të familjes, marrëdhëniet e prishura dhe dhunën në martesë dhe në familje, adoptimin, tutorinë, mbajtjen, si dhe procedurën para gjyqit në kontestet martesore dhe familjare.” Juridikisht, familja tradicionale krijohet me lidhjen e martesës në mes të një burri dhe një gruaje.¹⁹ Në bazë të ligjit nuk lejohet martesa e personave të së njëjtës gjini edhe përkundër nxitjeve dhe rekomandimeve të organizatave dhe institucioneve të caktuara nga jashtë.

Llojet e lidhjeve familjare dhe martesave

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut: “Burrat dhe gratë e moshës madhore, pa ndonjë kufizim të bazuar në racë, kombësi apo religjion, kanë të drejtën e martesës dhe krijimit të familjes. Ata kanë të drejta të barabarta për martesë, gjatë martesës dhe shpërbërjes së saj. Asnjë martesë nuk mund të lidhet në mënyrë të ligjshme pa pajtimin e plotë dhe të lirë të dy palëve, i cili pajtim duhet të shprehet nga ata personalisht pas shpalljes adekuate dhe nën praninë e organit kompetent për solemnizimin e martesës dhe dëshmitarëve, në mënyrën e parashikuar me ligj” (UNHR).

Martesa është gjendja e bashkimit të një personi me një tjetër si bashkëshortë në një lidhje ligjore, me pajtim të ndërsjellë dhe marrëveshje të pranuar dhe sanksionuar dhe prishur vetëm në bazë të ligjit (Merriam-Webster Dictionary).

Ekzistojnë martesat të cilat bëhen ndërmjet dy personave të gjinisë së njëjtë, por të cilat janë objekt kundërshtimi nga shumica e njerëzve dhe qeverive, bazuar edhe në traditën familjare të shoqërisë njerëzore, në besimin fetar por edhe legjislacionin mbi familjen, por, nga ana tjetër, tashmë të njohura me ligj nga një numër shtetesh, duke përfshirë edhe ShBA-të, bazuar në vendimin e Gjykatës Supreme në rastin *Obergefell v. Hodges* të vitit 2015.²⁰

Martesa konsensuale është bashkësi ku dy partnerë dakordohen lirshëm dhe me vetëdije që të lidhin martesë, me komunikim të hapur, respekt të ndërsjellë dhe betimin për vendimmarrje të përbashkët.²¹ Kurse, një bashkim konsensual nënkupton dy persona të cilët jetojnë bashkë në një shtëpi dhe janë në një lidhje të ‘ngjashme me martesën’, por nuk janë të martuar në mënyrë formale sipas ligjit. Dhe, për dallim nga këto, *martesa tradicionale* është lidhje martesore me përkushtim afatgjatë, e cila shpeshherë përcillet nga një mori normash konvencionale, kulturore, religjioze dhe sociale. Në përgjithësi, kjo martesë respekton në mënyrë fundamentale si udhëzimet fetare, ashtu edhe karakteristikat kulturore të cilat mbështesin unitetin familjar, besnikërinë, tiparin nuklear të familjes dhe nga ana tjetër, janë të përfshira në kornizën

¹⁹ <https://akademik.mk/sq/e-pas-marteses-shkurorezim/>

²⁰ Urdhri më i ri ekzekutiv i Presidentit Donald Trump i datës 23 janar, 2025 deklaroi që Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të njohin vetëm “dy gjini, mashkull dhe femër” - veprim i cili mund të ndikojë si praktikisht, ashtu edhe psikologjikisht te njerëzit të cilët deklarojnë një gjini ndryshe nga ato natyrore, si trans apo jobinare, sikurse mund të ndikojë edhe në lidhjet martesore të tyre.

²¹ <https://themonogamyexperiment.com/consensual-marriage/>

formale ligjore.²² Përderisa martesë tradicionale, në të shumtën e rasteve përfshin qëndrimin dhe pritjet shoqërore dhe familjare, martesë konsensuale bazohet në vendimin e lirë dhe mirinformuar të dy partnerëve, duke u përqendruar në autonomi dhe barazi.

Përderisa martesë tradicionale përqendrohet përveç tjerash, në statusin social (madje të familjes), gjendjen ekonomike, nderin familjar dhe lindjen e fëmijëve, *martesë moderne* ose bashkëkohore nuk i jep shumë rëndësi kësaj tradite dhe kulture familjare, por ajo është më fleksibile dhe përqendrohet në autonominë, vlerat dhe harmoninë personale të individit, duke kërkuar gjithnjë barazinë dhe integritetin ndërmjet partnerëve, dashurinë dhe plotësimin e nevojave shpirtërore. Pra, duke e anashkaluar pikëpamjen mbi vlerat grupore dhe duke u dhënë prioritet vlerave individuale, kjo martesë u shkon për shtati edhe ndryshimeve dhe trendëve të sotëm shoqërorë, kulturorë dhe ligjorë, të cilët e llogarisin atë një partneritet i cili respekton komunikimin e hapur dhe teknologjinë, qëllimet e përbashkëta, përshtatjen e obligimeve familjare dhe roleve gjinore (PapersOwl, Sep, 2024).

Të gjitha format e lidhjeve martesore të përmendura kanë për bazë dhe qëllim lidhjen e një personi me një person tjetër, tradicionalisht një mashkull me një femër, e cila ndryshe është e njohur si *monogami*. Ky është modeli i familjes me të cilin janë identifikuar martesat për shekuj me radhë, ku një person e lidh dhe ia përkushton jetën një personi tjetër, partnerit të zgjedhur, si nga aspekti emocional dhe romantik, ashtu edhe nga ideali dhe qëllimi për jetë të përbashkët ekskluzive përjetësisht.

Përveç monogamisë, ka njerëz që praktikojnë edhe forma të tjera lidhjesh, siç është *poliamoria*, e cila nënkupton lidhje romantike të njëkohshme me më tepër partnerë. Ose, *lidhja e hapur*, si një formë hibride në të cilën partnerët përveç përkushtimit ndaj njëri-tjetrit, mund të hyjnë në lidhje emocionale dhe gjinore edhe me partnerë të tjerë. Mënyrë tjetër e lidhjes ‘martesore’ është edhe *lidhja anarkike*, e cila tenton t’i kundërvihet rregullave të përmendura për ekskluzivitet me një partner, duke përcaktuar vet mënyrën e lidhjes, bazuar në nevojë, dëshirë dhe vlera personale. Motoja e kësaj forme martesore është kundërshtimi i bindjeve shoqërore në favor të qëndrimeve ‘autentike’ personale.

Conclusions

In today’s world the majority of people and families still hope and try to nurture and cultivate the traditional way of creating and maintaining their families and family life, or at least try to make an effort to keep the core values of what it used to be before. But, in reality, the way our families used to be structured and organized in the past, now are changing fast and drastically and the changes are taking their big toll. Changes aren’t affecting just some

²² <https://themonogamyexperiment.com/traditional-marriage-vs-open-marriage/>

particular people, a particular nation, or a few ones, or even some insignificant aspects of family creation and its way of functioning, and it's not just what we're used to hear and say that, it is mainly the western world. No, it is affecting the rest of the world as well, and with some radical developments, too. First of all, the traditional extended family is being replaced by smaller family units, mainly the nuclear type of family, but that is not all! Additionally, there are other types of unions and alternative family structures, such as, single parent ones, mixed ones with stepparents, even those with same sex couples or parents, or other types of unions in cohabitation or an open relationship, and many other extremes that are hybrid in nature and without real commitments. The same goes for marriage, where once again, we witness lower rates in marriages, especially traditional ones, where young people's age is rising at their first marriage, individual families becoming smaller in number, lower fertility in both females and males, and subsequently, fewer born children in their families. Numbers grow high in divorced couples and it contributes to many more remarriages and mixed families of parents and children. A number of people choose not to get married or create a family at all, or instead they take the option of some type of emotional affair or relationship and avoid taking greater and further commitment and responsibility. The transition from traditional to modern marriage shows how people and cultures grasp and rejoice the standards and principles that the contemporary and globalized world has to offer, with its high tech tools, views of personal worth and liberal choice. It's not about keeping the family together, having kids and growing old to see how grandchildren are brought about and how that tradition thrives. The modern way marriage is all about finding the path to personal happiness, achievement and riches, emotional accomplishment and glory. So, skipping traditional group values to individual expectations has made marriage a partnership based on prearranged goals and respect. Family roles and obligations, especially gender roles are changing too, where gender equality is pushing for equal contribution to work and household work, parenting and many other roles. Due to economic, industrial, technology and hybrid labor market, access to education, many young girls and women have taken more jobs and have become an equal part of the labor force. New laws and technology, equally encouraged by movements and voices on gender equality and legal framework advancements in their favor, have broadened the definition of marriage and family, making them more inclusive and flexible. And, it's not just marriage and family that evolve with our society, it's the way new technologies are shaping the whole world and setting new standards for our future.

Referencat:

Andrés Felipe Castro Torres, Luca Maria Pesando, Hans-Peter Kohler, Frank Furstenberg: Family change and variation through the lens of *family configurations* in low-and middle-income countries (<https://doi.org/10.1002/psp.2531>).

Bongaarts J, Mensch BS, & Blanc AK (2017). *Trends in the age at reproductive transitions in the developing world: The role of education. Population Studies*, 71, 139–154.

Frank F Furstenberg: Family Change in Global Perspective: How and Why Family Systems Change (<https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC8298013/#ABS1>).

Goldscheider F, Bernhardt E, & Lappegard T (2015). The gender revolution: A framework for understanding changing family and demographic behavior. *Population and Development Review*, 41, 207–239.

Grundy E (2006). Ageing and vulnerable elderly people: European perspectives. *Ageing & Society*, 26, 105–134.

McDonald P (2000). Gender equity in theories of fertility transition. *Population and Development Review*, 26, 427–439.

Ruggles S, & Heggeness M (2008). Intergenerational coresidence in developing countries. *Population and Development Review*, 34, 253–281.

Taylor HO, Taylor RJ, Nguyen AW, & Chatters L (2018). Social isolation, depression, and psychological distress among older adults. *Journal of Aging and Health*, 30, 229–246.

The Ethical, Legal, and Social Issues Impacted by Modern Assisted Reproductive Technologies (<https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC3261493/>).

Therborn G (2004). *Between sex and power: Family in the world, 1900–2000*. London: Routledge.

Thornton A, & Young-DeMarco L (2004). Four decades of trends in attitudes towards family issues in the United States: The 1960s through the 1990s. *Journal of Marriage and Family*, 63, 1009–1037.

William J. Goode (1963). *World Revolution and Family Patterns*.

Yount KM (2009). Women’s “justification” of domestic violence in Egypt. *Journal of Marriage and Family*, 71, 1125–1140.

Enti Shtetëror i Statistikës i Maqedonisë së Veriut (2022).

Encyclopaedia Britannica.

<https://www.britannica.com/topic/extended-family> (Apr 25, 2025).

EUROSTAT: Marriage and divorce statistics

(<https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/>).

Marriage. Merriam-Webster.com Dictionary, Merriam-Webster,

(<https://www.merriam-webster.com/dictionary/marriage>. Accessed 26 Apr. 2025).

PapersOwl, (Sep, 2024). Difference between Traditional Marriage and Modern Marriage (<https://papersowl.com>).

United Nations Human Rights: Convention on Consent to Marriage, Minimum Age for Marriage and Registration of Marriages.

The Alliance for Global Women's Medicine (GLOWM).

Wikipedia the Free Encyclopedia. Assisted Reproductive Technology (Apr, 27, 2025.

World Health Organization (WHO).

World Population Review, 2025.

<https://akademik.mk/sq/e-pas-marteses-shkurorezim/>

<https://www.americansurveycenter.org/research/emerging-trends-and-enduring-patterns-in-american-family-life>

<https://www.stowefamilylaw.co.uk/family-law/cohabitation-lawyers/what-is-cohabitation/>

<https://themonogamyexperiment.com/traditional-marriage-vs-open-marriage/>